



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

01-349

Datë/a:	27.05.2020
Referenc-ë:	05-070/01-43407/20 dt. 24.02.2020
Nga/ Od/ From:	Zejnulla Rexhepi, zyrtar, Drejtoria e Urbanizmit
Për/ Za/ To:	1. Bashkësia Lokale Hajvali - Prishtinë
Përmes/ preko/ through:	Mimoza Berisha Prestreshi u.d. Udhëheqëse e sektorit,
Tema/ Subjekat/Subject:	Informim



Bashkësia Lokale Hajvali, me shkresën zyrtare “Ankesë” 05-070/01-43407/20 dt. 24.02.2020, të parashtruar si, i janë drejtuar Drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Prishtinës, lidhur me ndërtimin e pompës së benzinës në magjistralen Prishtinë-Gjinal ana e djathtë.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të ankesës ka konstatuar se e njëjta është parashtruar në fazën e njoftimit publik (19.02.2020 – 05.03.2020) të kërkesës 05-350/02-27081/20 dt. 03.02.2020, të parashtruar nga pronari/investitori “Euro-Miti” sh.p.k., me certifikatë të regjistrimit të biznesit 810652554, me pronar Sait Grainca, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për lejin e ndërtimit të ndërtesës me karakter të përkohshëm - pikë e furnizimit me derivate, në parcelën kadastrale nr. 1328-1 ZK Hajvali, e cila shtrihet në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal në Prishtinë.

Bashkësia Lokale Hajvali, në ankesën e lartcekur kanë kërkuar si në vijim, citoj:

“Në bazë të peticionit të nënshkruar nga qytetarët e Hajvalisë të parqitur pranë B.Lokale lidhje me ndërtimin e Pompës së Benzinës në hyrje të hajvalisë anën e djathtë, banorët kërkojnë që mos të lejohet ndërtimi i kësaj pike të karburantit për deri sa të zgjerohet rruga në katër korsi me të gjithë trotuare pasi që projekti është i gatshëm të filloj zgjerimi i rrugës, kështu që të mos kemi pengesa gjatë realizimit të magjstrales që jemi duke pritur që 20 vite.”

Drejtoria e Urbanizmit, pas shqyrtimit të ankesës suaj Ju informon se, kërkuesi “Euro-Miti” sh.p.k., me certifikatë të regjistrimit të biznesit 810652554, me pronar Sait Grainca, me kërkesën me nr. 05-350/02-27081/20 dt. 03.02.2020, i është drejtuar kësaj Drejtorie me kërkesë për caktimin e kushteve ndërtimore për lejin e ndërtimit të ndërtesës me karakter të përkohshëm - pikë e furnizimit me derivate, në parcelën kadastrale nr. 1328-1 ZK Hajvali, e cila shtrihet në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal në Prishtinë.

Bazuar në Nenin 2, të “Rregullore për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridik” të miratuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, thuhet citoj: “Në bazë të kërkesës së personit fizik dhe juridik, organi kompetent i komunës për ndërtim lëshon lejen ndërtimore për objektet me karakter të përkohshëm për një afat të caktuar kohor”.

Po ashtu, në Nenin 7, pika 1, të “Rregullore për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridik”, 01. nr. 110-288305, më 31.12.2014 të miratuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, thuhet, citoj:

1. Lejet ndërtimore për objektet me karakter të përkohshëm, kanë afat të caktuar kohor.

*emite përgjelljen +
poste dt. 08.06.2020*

2. *Organi kompetent i Komunës për ndërtim mund të shfuqizojë lejen e ndërtimit:*

2.1 *nëse realizohet plani rregullues;*

2.2 *nëse ndryshojnë rrethanat, në bazë të të cilave është dhënë leja ndërtimore dhe*

2.3 *kur nuk respektohet plani i projektit, në bazë të cilit është lëshuar leja ndërtimore.*

Bazuar në pikën 1, 2, 2.2, të nenin të lartcekur, Komuna ka të drejtë të shfuqizojë lejen ndërtimore në rast se ndryshojnë rrethanat në lokacion/parcelë.

Po ashtu në Neni 12, “*Rregullore për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridik*”, 01. nr. 110-288305, më 31.12.2014 të miratuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, thuhet, citoj:

1. *Kur plotësohen rrethanat e parapara sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje për shfuqizimin e lejes për objekt të përkohshëm, pronari obligohet që objektin ta largojë vet.*

2. *Organi kompetent komunal e cakton një afat kohor jo më të shkurtë se tetë (8) ditë, brenda së cilit pronari obligohet ta largojë objektin e përkohshëm.*

3. *Nëse poseduesi i lejes së ndërtimit nuk e largon objektin në afatin e dhënë në paragrafin 2 të këtij neni, objekti largohet nga Komuna.*

4. *Shpenzimet për largimin e objekteve i përkasin pronarit.*

Andaj, bazuar në të thënat e lartcekura, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës Ju informon se, kërkesa e parashtruar 05 nr. 350/02-27081/20 dt. 03.02.2020, nga pronari/investitori “Euro-Miti” sh.p.k., me certifikatë të regjistrimit të biznesit 810652554, me pronar Sait Grainca, për caktimin e kushteve ndërtimore për lejimin e ndërtimit të ndërtesës me karakter të përkohshëm - pikë e furnizimit me derivate, është kërkesë e bazuar në “*Rregullore për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridik*”, 01. nr. 110-288305, më 31.12.2014 të miratuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës.

Në rast të miratimit të ndonjë projekti eventual nga Ministria e Infrastrukturës apo fillimit të realizimit të zgjerimit të magjistrales Prishtinë-Gjilan në lokacionin ku gjendet parcela në fjalë, konform neneve dhe pikave të lartcekura të “*Rregullore për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridik*”, 01. nr. 110-288305, më 31.12.2014 të miratuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, do të shfuqizoj lejen ndërtimore dhe ndërtimi do të largohet nga parcela në fjalë.

Kjo shkresë është përpiluar në 5 (pesë) kopje origjinale dhe i dërgohet: Kërkuesit, kësaj Drejtorie, në dosje të lëndës, në lëndën nr. 05-350/02-27081/20 dt. 03.02.2020, dhe Qendrës për shërbim me Qytetar.